


**RAPORTI I  
HULUMTIMIT  
TË OPINIONIT**

# LIDHUR ME QËNDRIMET DHE SJELLJET E VOTUESVE TË RINJ

SHKURT 2018






**RAPORTI I  
HULUMTIMIT  
TË OPINIONIT**

# **LIDHUR ME QËNDRIMET DHE SJELLJET E VOTUESVE TË RINJ**

**SHKURT 2018**



COPYRIGHT © 2018.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Autori: **Ahmet Rushiti**

Kontribuoi në raport: **Eugen Cakolli**

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

- 02** Hyrje
- 03** Metodologjia e hulumtimit
- 04** Bindjet dhe deklaratimet e votuesve të rinj
  - 04** Drejtimi i vendit
  - 05** Shqetësimet kryesore të të rinjve të Kosovës
  - 06** Niveli i besueshmërisë në institucione
  - 07** Vlerësimi i punës së Qeverisë
  - 08** Arsyet që do t'i shtynin të rinjtë të bëhen pjesë e partive politike
  - 08** Ndikimi i familjes në përcaktimin e votuesve të rinj
  - 10** Pjesëmarrja dhe votimi në zgjedhjet parlamentare 2017
  - 12** Pjesëmarrja dhe votimi në zgjedhjet lokale 2017
  - 14** Politikanët model për të rinjtë
- 15** Qëndrimet dhe sjelljet e votuesve të subjekteve politike
  - 16** Deklarimet
  - 16** Drejtimi i vendit
  - 17** Shqetësimet kryesore
  - 18** Vlerësimi i punës së qeverisë
  - 19** Ndikimi i fesë në vendimet që ata marrin
  - 20** Gjendja financiare familjare
  - 21** Politikani model
  - 22** Lojaliteti Partiak
  - 23** Votimi nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër
- 24** Segmentimi XYZ
- 30** Përfundimet
- 31** Rekomandimet



# HYRJJE

Duke marrë parasysh se në vjeshtën e vitit 2017 përfundonin mandatet e kryetarëve dhe asambleve komunale dhe se zgjedhjet lokale do të organizoheshin branda afatit kushtetues, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në dhjetor të vitit 2016 pati realizuar matjen e opinionit publik për votuesit e rinj. Qëllimi i hulumtimit ka qenë që për herë të parë të hulumtohen dhe të analizohen qëndrimet dhe sjelljet e votuesve të rinj përballë proceseve politike dhe zgjedhore.

Në Kosovë, sipas legjislacionit në fuqi, i ri/e re konsiderohet çdo banorë dhe person i regjistruar në Kosovë nga moshën 15 – 24 vjeç<sup>1</sup>. Kosova konsiderohet si një nga vendet me popullsinë më të re në moshë. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës popullsia e Kosovës nga moshën 15 – 24 vjeç përbën 19.33 për qind e popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

Të drejtë vote në Kosovë, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka secili banor apo person i regjistruar në Kosovë që në ditën e zgjedhjeve mbush 18 vjeç. Më 11 qershor të vitit 2017 janë organizuar zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në kuadër të mandatit të tij për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Kosovës, me 31 maj 2017, ka miratuar vendimin për listën e plotë të votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës<sup>2</sup>. Sipas këtij vendimi numri i atyre që për herë të parë do të votojnë në këto zgjedhje ka qenë 118,448 ose 6.32 për qind e listës totale të votuesve.

Sa i përket zgjedhjeve lokale të 22 tetorit të vitit 2017, KQZ miratoi listën përfundimtare të votuesve më datë 22 shtator, listë në të cilën u shtuan emrat e 14,176 personave me të drejtë vote, që kanë arritur moshën për të votuar deri në ditën e zgjedhjeve.

Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të votuesve që do të votonin për herë të parë dhe faktin që në Kosovë gjatë vitit 2017 janë organizuar dy palë zgjedhje, të nivelit qendror dhe të atij lokal dhe duke marrë parasysh rezultatet e hulumtimit të opinionit publik të realizuar me votuesit e rinj në Kosovë gjatë vitit 2016, KDI e ka vlerësuar të arsyeshme që të realizojë edhe një hulumtim me votuesit e rinj dhe të bëjë një krahasim me hulumtimin e vitit 2016.

Ky raport paraqet një analizë dhe krahasim kualitativ të të dhënave të nxjerra nga zhvillimi i dy hulumtimeve. Në pjesën e parë raporti fokusohet në krahasimin e çështjeve deklarative në raport me vitin e kaluar. Pjesa e dytë do të përfshijë preferencat politike dhe mënyrën se si të rinjtë kanë votuar në zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe ato lokale. Pjesa e fundit e hulumtimit përfshin segmentimin e votuesve në bazë të përgjigjeve e tyre si dhe qëndrimet dhe sjelljet e votuesve të rinj ndaj subjekteve të ndryshme politike.

1 [http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji\\_03-L-145\\_per\\_Fuqizim\\_dhe\\_Pjesemarrje\\_te\\_Rinise.pdf](http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_03-L-145_per_Fuqizim_dhe_Pjesemarrje_te_Rinise.pdf)

2 [http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/119-1762-2017-Vendim-per-certifikimin-e-listes-perfundimtarete-votuesve\\_2017-09-22\\_1\\_eaylgbihig.pdf](http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/119-1762-2017-Vendim-per-certifikimin-e-listes-perfundimtarete-votuesve_2017-09-22_1_eaylgbihig.pdf)






# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Sa i përket metodologjisë hulumtuese, është përzgjedhur tipi kuantitativ i hulumtimit, përkatësisht intervistat ballë për ballë në shtëpi. Hulumtimi ka përfshirë 1,200 të anketuar, prej tyre 50.9 për qind vajza dhe 49.1 për qind djem. Për të siguruar përfaqësimin e popullsisë në bazë të përkatësisë etnike, 70.8 për qind e të anketuarave kanë qenë shqiptarë, 16.7 për qind serbë dhe 12.5 për qind nga komunitetet tjera jo-shumicë. Për të garantuar përfshirje të të anketuarve edhe në bazë të

vendbanimit, 55.5 për qind e tyre kanë qenë nga zonat rurale dhe 44.5 për qind nga zonat urbane. Shkalla e gabimit është  $\pm 2.74$  për qind. Ky hulumtimi është zhvilluar nga data 12 deri më 24 dhjetor të vitit 2017.

Hulumtimi i parë është kryer në dhjetor të vitit 2016. Këto qëndrime, në thelb paraqesin sjelljen e votuesve (nga anglishtja "voting behaviour").




# BINDJET DHE DEKLARIMET E VOTUESVE TË RINJ

## Drejtimi i vendit

Në pyetjen se si e shohin të rinjtë drejtimin e gjërave në vend këtë vit, 61.5 për qind e të rinjve mendojnë se gjërat në vend


nuk janë duke shkuar në drejtimin e duhur, fakt ky që përbën një shqetësim për shpresën dhe të ardhmen e tyre në Kosovë, ndërkaq, 29.3 për qind e të intervistuarve mendojnë se proceset janë duke u zhvilluar në drejtimin e duhur.

**GRAFI 1 - Në përgjithësi, a mendoni që gjërat në Kosovë janë duke shkuar...**





## Shqetësimet kryesore të të rinjve të Kosovës




Pjesë e rëndësishme e hulumtimit ka qenë edhe evidentimi i shqetësimeve të të rinjve. Të anketuarit janë pyetur lidhur me pesë shqetësimet e tyre kryesore. Nga rezultatet mund të konstatohet se problemet që të rinjtë i kanë nuk adresohen nga institucionet në Kosovë, qoftë në nivelin qendror e po ashtu edhe në nivelin lokal.

Papunësia me 68.7 për qind, liberalizimi i vizave me 61.9 për qind, shëndetësia me 57.1 për qind, luftimi i korrupsionit me 50.2 për qind dhe zhvillimi ekonomik 45 për qind, paraqesin pesë shqetësimet kryesore të të rinjve.

Temat tjera mjaft të debatuar si: demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, transformimi i FSK-së në ushtri, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe apo ekstremizmi fetar nuk paraqiten si probleme kryesore nga të rinjtë e Kosovës, duke qenë se renditen në fund të listës së shqetësimeve të të rinjve.

Bazuar në ndarjen etnike të respondentëve të këtij hulumtimivlen të theksohet se shqetësimi kryesor i të tri grupeve është **papunësia**. Kjo përqindje është më e theksuar tek të anketuarit e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera jo-shumicë (76.5 për qind, respektivisht 74 për qind), për dallim nga të rinjtë e komunitetit shqiptar, tek të cilët kjo përqindje është relativisht më e ulët (68.2 për qind).


### Shqetësimet e të rinjve shqiptarë të Kosovës






**Liberalizimi i vizave**, si shqetësim, paraqitet në shifra mjaft të larta tek të rinjtë shqiptarë (62.7 për qind) dhe te komunitetet tjera (64 për qind). Ndërsa, për të rinjtë e komunitetit serb, mungesa e liberalizimit të vizave paraqitet si shqetësim vetëm tek 34.5 për qind e tyre.

### Shqetësimet e të rinjve serbë të Kosovës



Ndonëse, çështjet tjera si Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, nuk paraqesin ndonjë shqetësim të madh për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, të anketuarit nga komuniteti serb konsiderojnë **ekstremizmin fetar** si një nga shqetësimet kryesore të tyre me 41.5 për qind.

### Shqetësimet e të rinjve nga komunitetet tjera të Kosovës




## Niveli i besueshmërisë në institucione

Rezultatet e nxjerra nga realizimi i hulumtimit tregojnë se ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit institucioni më i besueshëm për të rinjtë mbetet komuna. Qeveria dhe partitë politike janë institucionet më pak të besuara nga ana e të rinjve. Për dallim nga viti i kaluar **ka një rritje të dukshme të besimit në prokurori dhe gjykata**. Të rinjtë e komunitetit serb, të intervistuar për këtë hulumtim, tregojnë një nivel më të ulët të besimit në institucionet kryesore të vendit.

Sa i përket nivelit të të hyrave familjare, pushteti komunal gëzon nivel më të lartë të besueshmërisë tek të rinjtë që vijnë nga familjet me të hyra mbi 900 EUR në muaj. Presidenca ka nivelin më të lartë të besueshmërisë tek të rinjtë nga familjet me të hyrat familjare deri në 150 EUR në muaj, ndërkaq Qeveria e Kosovës, gëzon më së shumti besim nga të anketuarit me të hyra familjare nga 150-300 EUR në muaj.

**Të rinjtë e komunitetit serb, të intervistuar për këtë hulumtim, tregojnë një nivel më të ulët të besimit në institucionet kryesore të vendit.**






## Vlerësimi i punës së Qeverisë

Sikurse në vitin 2016, edhe në fund të vitit 2017, të rinjtë shfaqin mungesë besueshmërie ndaj Qeverisë së Kosovës dhe shfaqen mjaft kritikues ndaj punës së saj. Sipas rezultateve të nxjerra nga ky hulumtim me të rinjtë e moshave 18 deri 22 vjeç, në mostër prej 1,200 respondentëve, 69.9 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se puna e Qeverisë së Kosovës është e dobët dhe jo efektive, ndërsa pjesa tjetër (rreth 30 për qind) kanë deklaruar se qeveria punon në interes të të gjithë qytetarëve të vendit dhe ajo shpesh kritikohet padrejtësisht nga qytetarët, përkundër punës

së mirë që bëjnë. Po ashtu, sipas rezultateve të këtij hulumtimi, një shumicë e konsiderueshme (71.6 për qind) e të rinjve shqiptarë, të anketuar në këtë hulumtim, kanë deklaruar se Qeveria punon për interesa të ngushta të grupeve të caktuara.

Të rinjtë nga komuniteti serb, kanë një nivel edhe më të lartë të pakënaqësisë me punën e Qeverisë së Kosovës, ku 79.5 për qind e tyre e vlerësojnë si të dobët dhe jo efektive punën e këtij institucioni, ndërsa, shumica (61.3 për qind) e të anketuarve nga komunitetet tjera jo shumicë vlerësojnë se puna e Qeverisë është e dobët dhe jo efektive.

### VLERËSIMI I PUNËS SË QEVERISË



Qeveria shpesh kritikohet padrejtësisht nga njerëzit përkundër punës së mirë

Puna e qeverisë është e dobët dhe jo efektive





Në pyetjen se cila sa ndikon familja në përcaktimin e votuesve të rinj, të moshave 18 deri 22 vjeç, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se të rinjtë përcaktohen për votën ndaj një kandidati apo një subjekti politik në pavarësi të plotë nga familja

**85.3%**






## Pjesëmarrja dhe votimi në zgjedhjet parlamentare 2017

Sikur edhe gjatë zgjedhjeve të kaluara, ku pjesëmarrja e të rinjve në procesin zgjedhor ka qenë në nivel më të lartë në krahasim me grup moshat tjera, ky trend ka vazhduar edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare të 11 qershorit. Bazuar në rezultatet e nxjerra nga hulumtimi me votuesit e rinj shumica dërrmuese e të rinjve, përkatësisht 71.2 për qind e të anketuarve, kanë marrë pjesë në zgjedhje. Ndërsa, pjesa tjetër (24.3 për qind) që nuk ka marrë pjesë në zgjedhje, si arsye kryesore për mospjesëmarrje e kanë renditur faktin se nuk kanë pasur të drejtë vote (44.9 për qind). Përqindja e të rinjve të cilët nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje për shkak se nuk kanë pasur preferenca për asnjërin subjekt politik

(18.6 për qind), si dhe për shkak të mungesës së interesimit në zgjedhje, duke deklaruar se nuk kanë kohë (18.3 për qind) apo zgjedhjet nuk kanë rëndësi (11.8 për qind), mbetet relativisht e lartë.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare, votuesit djem kanë marrë pjesë në përqindje pak më të lartë (78 për qind), krahasuar me votueset vajza (71.3 për qind). Marrë parasysh përkatësinë etnike të të anketuarve, votuesit e komunitetit shqiptar kanë përqindjen më të lartë të votimit, me 75.9 për qind, kurse votuesit nga komunitetet tjera jo shumicë në vend, që kanë votuar në zgjedhjet parlamentare arrijnë në shifrën prej 64 për qind. Votuesit e rinj nga komuniteti serb kanë nivelin më të ulët të pjesëmarrjes, me vetëm 30.7 për qind.






Rajoni i Prishtinës është rajoni me përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje (87.2 për qind), pasuar nga rajoni i Gjilanit (80.3 për qind), rajoni i Prizrenit (75.5 për qind), rajoni i Mitrovicës (75 për qind), rajoni i Gjakovës (65.3 për qind), rajoni i Ferizajt (64.5 për qind) dhe rajoni i Pejës (59.3 për qind).

Në bazë të ndarjes së të anketuarve sipas të ardhurave mujore që gjenerojnë familjet e tyre, mund të konkludohet se grupi me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në zgjedhje janë të rinjtë, familjet e të cilëve gjenerojnë të ardhura mujore 451 deri në 600€, me 87.9 për qind. Ndërsa, vetëm 57.7 për qind e të rinjve që gjenerojnë të ardhura minimale në familjet e tyre, përkatësisht vetëm 0 deri në 150€, kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor të 11 qershorit.

Sipas deklarimeve të të rinjve të anketuar në këtë hulumtim, subjekti më i votuar në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit, është koalicioni PAN me 33.1 për qind, i pasuar nga Lëvizja Vetëvendosje me 28.7 për qind, si dhe koalicioni LAA me 21.3 për qind. Lista Serbe është votuar nga vetëm 1 për qind e të anketuarve, kurse subjektet tjera janë votuar nga 0.8 për qind e të anketuarve. 15.1 për qind e të rinjve të anketuar kanë refuzuar të përgjigjen se për kë kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit.

Faktorët determinues të cilët të rinjtë i kanë marrë parasysht kur janë përcaktuar se për kë do të votojnë, janë: programi politik (30.6 për qind), kandidatët për deputetë (16.3 për qind), kandidati për kryeministër (13.9 për qind) dhe lideri i partisë (13 për qind).



Faktorët determinues të cilët të rinjtë i kanë marrë parasysht kur janë përcaktuar se për kë do të votojnë, janë:

- PROGRAMI POLITIK ✓ **30.6%**
- KANDIDATËT PËR DEPUTETË ✓ **16.3%**
- KANDIDATI PËR KRYEMINISTËR ✓ **13.9%**
- LIDERI I PARTISË ✓ **13%**







## Pjesëmarrja dhe votimi në zgjedhjet lokale 2017

Zgjedhjet lokale të mbajtura më 22 tetor të vitit 2017, kanë shënuar trend të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve, krahasuar me zgjedhjet parlamentare të mbajtura në qershor. Diferenca në pjesëmarrjen e të rinjve është rreth 6 për qind. Derisa 71.2 për qind e të anketuarve kishin deklaruar se kanë votuar në zgjedhjet e 11 qershorit, në pyetjen lidhur me zgjedhjet lokale, kjo shifër është rritur në 77.4 për qind. Sikur edhe në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit, edhe në zgjedhjet lokale, arsyet kryesore për mospjesëmarrje e pjesës tjetër të të rinjve (17.5 për qind) janë radhitur mungesa e së drejtës për votë (33.9 për qind), mungesa e kohës për të votuar (22.2 për qind) apo mungesa e preferencës për ndonjërin prej subjekteve politike (18.1 për qind).

Bazuar në ndarjen e të anketuarve në baza gjinore, dhe krahasuar me të dhënat nga zgjedhjet parlamentare, rezultojnë se ka rritje të përqindjes së votuesve vajza nga 71.3 për qind, sa ishte në zgjedhjet parlamentare, në 79.1 për qind në ato lokale. Sidoqoftë, në përqindje të përgjithshme, sërish del se votuesit djem kanë votuar në përqindje më të lartë (84.1 për qind), krahasuar me votueset e gjinisë tjetër.

Sipas rezultateve të këtij hulumtimi, të anketuarit nga komuniteti shqiptar kanë nivel më të lartë të pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale (83.2 për qind), krahasuar me të anketuarit nga komunitetet tjera (74.4 për qind), dhe të anketuarit nga komuniteti serb (27.6 për qind), të cilët kanë shënuar nivelin më të ulët të pjesëmarrjes. Nëse këto të dhëna krahasohen me ato të pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare, mund të konstatohet se të rinjtë nga komuniteti shqiptar



Bazuar në ndarjen e të anketuarve në baza gjinore, dhe krahasuar me të dhënat nga zgjedhjet parlamentare, rezultojnë se ka rritje të përqindjes së votuesve vajza nga **71.3 për qind, sa ishte në zgjedhjet parlamentare, në 79.1 për qind në ato lokale.**





tar dhe komunitetet tjera jo-shumicë kanë treguar interesim më të madh për të votuar në zgjedhjet lokale sesa në ato parlamentare. Kurse, të anketuarit nga komuniteti serb kanë interesim relativisht më të madh për të votuar në zgjedhjet parlamentare.


Nëse të anketuarit ndahen në bazë të regjioneve prej nga vijnë, regjioni me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhjet lokale është Ferizaj, me 90.4 për qind pjesëmarrje, pasuar nga rajoni i Prishtinës me 88.8 për qind, rajoni i Gjilanit me 82.9 për qind, rajoni i Gjakovës me 80.6 për qind, rajoni i Prizrenit me 79 për qind, rajoni i Mitrovicës me 77.2 për qind, si dhe rajoni i Pejës me 63.8 për qind, që shënon nivelin më të ulët të pjesëmarrjes.

Fakti interesant i nxjerrë nga ky hulumtim është se të rinjtë e anketuar, që janë përgjigjur se kanë votuar në zgjedhjet lokale,

kanë deklaruar se kanë votuar më shumë për kryetar komune (në 98.8 për qind të rasteve), sesa për kuvendet komunale të komunave përkatëse (në 93.6 për qind të rasteve). Përfaqësimi i duhur i interesave të tyre (78.5 për qind) përbën arsyen më të shpeshtë se pse të rinjtë kanë votuar një kandidat të caktuar për kuvende komunale. Miqësia me kandidatin për kuvend komunal, apo afërsia familjare me të, janë dy arsye tjera të listuara nga të rinjtë si faktorë që kanë ndikuar në votimin për një kandidat për kuvendin komunal, me 10.2, respektivisht 10.1 për qind.

Për sa i përket fushatës zgjedhore, del se ndikimi i saj në përcaktimin e votuesve për zgjedhjet lokale ka qenë minimal. Këtë e mbështet fakti që 86.2 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë qenë të përcaktuar se për kë do të votojnë para fillimit të fushatës.

Për sa i përket fushatës zgjedhore, del se ndikimi i saj në përcaktimin e votuesve për zgjedhjet lokale ka qenë minimal. Këtë e mbështet fakti që 86.2 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë qenë të përcaktuar se për kë do të votojnë para fillimit të fushatës.






## Politikanët model për të rinjtë

Preferencat politike të të rinjve, janë të lidhura ngushtë edhe me politikanët e tyre të preferuar, në kuptimin e një modeli që të rinjtë e shohin si më të duhurin për ta ndjekur. Sidoqoftë, përkundër faktit që këto dy komponentë janë të lidhur me njëri-tjetrin, përqindja e të rinjve të cilët nuk e shohin asnjë nga politikanët aktual si model që duhet ndjekur, është më e lartë sesa përqindja e politikanit që shihet si model nga të rinjtë tjerë. Rezultatet e këtij hulumtimi, tregojnë se 25.2 për qind e të rinjve nuk kanë **asnjë** politikan model. Përqindje më e theksuar e të rinjve që nuk kanë asnjë politikan model vërehet tek të rinjtë e komunitetit serb, 81 për qind e të cilëve kanë deklaruar se nuk kanë fare politikan model nga klasa politike aktuale.

Kurse, pjesa tjetër e të rinjve kanë dhënë mbi 50 emra të politikanëve, të cilët sipas tyre janë model për t'u ndjekur nga të rinjtë. Kësaj liste i prin Albin Kurti, i cili shihet si politikan model nga 13.7 për qind e të rinjve. Pas tij, si politikanët më popullor, janë radhitur Ramush Haradinaj me 7.8 për qind, pasuar nga Vjosa Osmani me 7.4 për qind, Shpend Ahmeti me 7.3 për qind, Hashim Thaçi me 7 për qind, dhe Kadri Veseli me 5.8 për qind.

Bazuar në ndarjen etnike të të anketuarve, del se politikan model për të rinjtë e komunitetit shqiptar është Albin Kurti (14.4 për qind), për të rinjtë e komunitetit serb është Slavko Simić (10 për qind), ndërsa të rinjtë e komuniteteve tjera jo-shumicë në Kosovë, kanë si politikan model Hashim Thaçin (6 për qind).





# QËNDRIMET DHE SJELLJET E VOTUESVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Pjesë e rëndësishme e hulumtimit ka qenë edhe gjenerimi i të dhënave që pasqyrojnë qëndrimet dhe sjelljet e votuesve të subjekteve të ndryshme politike në Kosovë, duke u bazuar në atë se si kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të mbajtura me 11 qershor 2017 dhe segmentimi i përgjigjeve të tyre për këta votues. Ky segmentim paraqet deklaratimet, sjelljet dhe qëndrimet e votuesve të rinj të koalicionit ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe


Nisma për Kosovën dhe partive tjera pjesë e këtij koalicionit ose shkurt PAN, koalicioni ndërmjet Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës Kosova e Re (AKR) dhe Alternativa, apo të njohur si LAA dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Ky segmentim do të ndihmojë subjekteve të tyre për të analizuar më mirë qëndrimet dhe sjelljet e votuesve të tyre, për të njohur shqetësimet e tyre, e poashtu për t'i adresuar çështjet që i preokupojnë ata.





# DEKLARIMET



## Drejtimi i vendit

Të rinjve, që në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit 2017, kanë votuar subjektin politik Koalicioni PAN (PDK, AAK, NISMA dhe të tjerët), në vijim të raportit do t'u referohemi si votuesi i PAN.


Të rinjve, që në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit 2017, kanë votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, në vijim të raportit do t'u referohemi si votuesi i LVV.

Të rinjve, që në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit 2017, kanë votuar subjektin politik Koalicioni LAA (LDK, AKR dhe Alternativa), në vijim të raportit do t'u referohemi si votuesi i LAA.

Të rinjtë që janë deklaruar se kanë votuar për subjektin politik koalicioni PAN, për dallim nga votuesit e subjekteve tjera, janë më optimistë lidhur me drejtimin në të cilin po shkon vendi. Rreth 46 për qind e këtyre të rinjve mendojnë se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur, ndërkaq 56 për qind mendojnë se gjërat në vend janë duke shkuar në drejtimin e gabuar.


Shumica e të rinjve të cilët janë deklaruar se kanë votuar Lëvizjen Vetëvendosje janë shprehur më pesimistë për drejtimin e vendit. Rreth 71.3 për qind e tyre mendojnë se gjërat në vend janë duke shkuar në drejtim të gabuar, për dallim nga 28.7 për qind e të rinjve të këtij grupi, të cilët mendojnë se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur.

Të rinjtë që kanë votuar këtë subjekt në një masë më të moderuar vlerësojnë se gjërat në vend janë duke shkuar në drejtimin e gabuar, ku për këtë janë deklaruar 63.4 për qind e tyre, ndërsa pjesa tjetër prej 26.8 për qind kanë deklaruar se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur.





## Shqetësimet kryesore




Votuesi  
i PAN

Shqetësimet kryesore të votuesit të koalicionit PAN, janë liberalizimi i vizave, papunësia, zhvillimi ekonomik, shëndetësia dhe luftimi i korrupsionit.






Votuesi  
i LVV

Ata të cilët e kanë votuar Lëvizjen Vetëvendosje, për dallim nga votuesit e koalicionit PAN, kanë renditur papunësinë si shqetësimin kryesor të tyre, pastaj shëndetësinë, liberalizimin e vizave, luftimin e korrupsionit si dhe arsimin.




Votuesi  
i LAA

Edhe për votuesit e koalicionit LAA papunësia përbën shqetësimin kryesor, mirëpo liberalizimi i vizave është renditur si shqetësim i dytë kryesor. Këto dy shqetësime pasohen nga shëndetësia, luftimi i korrupsionit dhe arsimit.





## Vlerësimi i punës së qeverisë




Votuesi  
i PAN

Për dallim nga votuesit e subjekteve tjera, si Lëvizja Vetëvendosje apo koalicionit LAA, votuesit e koalicionit PAN e vlerësojnë mirë punën e qeverisë me 49.7 për qind, ndërsa pjesa tjetër mendon se puna e qeverisë është e dobët dhe jo efektive. Po ashtu, votuesit e PAN janë të ndarë në dysh sa i përket pyetjes se a i përfaqëson qeveria interesat e tyre apo qeveria përfaqëson vetëm interesat e një grupi të caktuar.



Votuesi  
i LVV


Nga hulumtimi i realizuar vërehet se votuesi i LVV, nuk e vlerëson aspak punën e qeverisë. 87 për qind e tyre janë deklaruar se puna e qeverisë është e dobët dhe efektive. Gjithashtu shumica dërrmuese e të anketuarve të cilët kanë deklaruar që kanë votuar për Lëvizjen Vetëvendosje mendojnë se qeveria i mbrojnë interesat e një grupi të caktuar dhe jo interesat e përgjithshme të qytetarëve.



Votuesi  
i LAA


Edhe votuesit e koalicionit LAA janë deklaruar se puna e qeverisë është e dobët dhe jo efektive. Përkundër faktit se njëri nga subjektet e këtij koalicioni, përkatësisht Aleanca Kosova e Re, është pjesë e koalicionit qeverisës, një pjesë e konsiderueshme e votuesve të këtij koalicioni (77.2 për qind) kanë deklaruar se puna e Qeverisë është e dobët edhe jo efektive.

 Puna e qeverisë është e dobët dhe jo efektive
  Qeveria shpesh kritikohet padrejtësisht nga njerëzit përkundër punës së mirë





## Ndikimi i fesë në vendimet që ata marrin




Në pyetjen se sa ka ndikim feja në vendimet që ata i marrin për çështje të caktuara në jetën e tyre, të anketuarit të cilët e kanë votuar koalicionin PAN, si shumicë dërmuese kanë deklaruar se feja nuk ka shumë ndikim në vendimet që i marrin. 68.1 për qind e të rinjve të këtij grupi, kanë thënë se feja nuk ka ndikim në vendimet që i marrin, ndërsa 30.1 për qind kanë deklaruar se feja ka ndikim në vendimet që ata i marrin.



Në të njëjtën pyetje, edhe votuesit të cilët e kanë votuar Lëvizjen Vetëvendosje, kanë deklaruar se feja nuk ka ndikim në vendimet që ata i marrin. Për këtë janë deklaruar 67 për qind e tyre.




Edhe votuesit e koalicionit LAA kanë qëndrim të njëjtë me votuesin e subjekteve tjera sa i përket ndikimit të fesë, që konsiderojnë se nuk ka ndikim të madh në vendimet që ata i marrin.





## Gjendja financiare familjare




Bazuar në rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim, del se shumica e të anketuarve (61.3 për qind) të cilët kanë deklaruar që kanë votuar koalicionin PAN, kanë gjendje financiare në familjet e tyre, e cila u mundëson t'i përballojnë shpenzimet mujore. Ndërsa, pjesa tjetër, që përbën 33.7 për qind e të anketuarve të këtij grupi, kanë kushte të vështira ekonomike, pasi që gjendja ekonomike e familjeve të tyre është e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e zakonshme mujore.




78.2 për qind, që përbën shumicën dërrmuese të votuesve të rinj të Lëvizjes Vetëvendosje, që është më i madh se i subjekteve tjera, kanë deklaruar se kanë gjendje të mirë ekonomike në familjet e tyre, pasi që kanë mundësi të përballojnë shpenzimet mujore. Kurse, 20.3 për qind e votuesve të rinj të këtij subjekti kanë gjendje jo të mirë financiare në familje, duke qenë se të ardhurat e tyre familjare janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet mujore.




Të rinjtë e anketuar që kanë deklaruar se kanë votuar koalicionin LAA, del se janë me gjendje financiare dukshëm më të mirë sesa grupet tjera. 82. për qind e tyre kanë deklaruar se kanë gjendje ekonomike familjare e cila ua mundëson të përballojnë shpenzimet mujore. Ndërsa, vetëm 16 për qind e tyre nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet mujore me gjendjen financiare të cilën e kanë.

 Gjendja financiare në familjen time na mundëson që të përballojmë shpenzimet mujore

 Gjendja financiare në familjen time është e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet mujore


 Nuk e di








## Politikani model




Votuesi  
i PAN

Liderët e këtij koalicioni, përfshirë edhe presidentin Hashim Thaçi, janë në fakt edhe politikanët më model për votuesit e këtij subjekti. Listës së politikanëve model, i prin kryeministri aktual Ramush Haradinaj (30.2 për qind), pasuar nga Hashim Thaçi (24.2 për qind) dhe Kadri Veseli (21.4 për qind). Përpos tyre, edhe politikanë tjerë si Agim Aliu (7.4 për qind) dhe Fatmir Limaj (5.6 për qind) janë politikani model për një numër të konsiderueshëm të të rinjve.



Votuesi  
i LVV

Votuesit e Lëvizjes Vetëvendosje janë më të ndarë në lidhje me politikanin model që ata kanë. Albin Kurti është politikan model i 53.6 për qind i votuesve të këtij subjekti. Albin Kurti pasohet nga Shpend Ahmeti, i cili është politikan model për 30.3 për qind e votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje. Për dallim nga subjektet tjera, votuesit e të cilave kanë numër më të madh të politikanëve model, në Lëvizjen Vetëvendosje janë vetëm dy politikanë model kryesorë, ndërsa pjesa tjetër e politikanëve të përmendur janë në përqindje minimale.




Votuesi  
i LAA

Si politikania më model për të rinjtë, të cilët e kanë votuar koalicionin LAA në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit, është Vjosa Osmani e cila është politikane model për pothuajse gjysmën e votuesve (45.8 për qind) të këtij subjekti. Pas saj radhitet Arban Abrashi me 10.7 për qind, dhe Isa Mustafa i cili është model për 9.2 për qind të votuesve të koalicionit LAA. Përveç tyre, nga partitë tjera të këtij koalicioni, Behxhet Pacolli është politikan model për 5.3 për qind të votuesve të rinj të këtij grupi të votuesve.






## Lojaliteti Partiak




Votuesi  
i PAN

Shumica e votuesve të koalicionit PAN, përkatësisht 51.7 për qind e tyre, kanë deklaruar se do të dëgjonin partinë se për cilin kandidat të votohet, në rast se vetë kandidati i kësaj partie nuk ka arritur të jetë në balotazh. Pjesa tjetër, respektivisht 29 për qind dhe 19.3 për qind e të anketuarve nuk do të dëgjonin partinë, apo nuk janë të vendosur se si do të vepronin në këso rasti.



Votuesi  
i LVV

Lëvizja Vetëvendosje, sipas rezultateve të këtij hulumtimi, del se ka votuesit më lojal, duke qenë se 60.4 për qind e të rinjve të anketuar, kanë deklaruar se do të dëgjonin partinë se për cilin kandidat të votohet në raundin e dytë. 24.6 për qind e votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të dëgjonin partinë, ndërsa pjesa tjetër (15 për qind) kanë deklaruar se nuk e dinë se si do të vepronin në këtë rast.




Votuesi  
i LAA

Në anën tjetër, krahasuar me partitë tjera, del se votuesit e koalicionit LAA janë më pak lojal. Vetëm 46.4 për qind e tyre do ta dëgjonin partinë se për kë të votojnë, për dallim nga 23.2 për qind të cilët nuk do ta dëgjonin partinë. 30.4 për qind e votuesve të këtij subjekti nuk janë të vendosur lidhur me këtë çështje. Sidoqoftë në përgjithësi, të tri subjektet kanë votues të rinj mjaft lojal, pasi që në asnjë rast të rinjtë që nuk do të dëgjonin partinë se për kë të votojnë në raundin e dytë, nuk janë në përqindje më të lartë se pjesa tjetër.






## Votimi nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër



Votuesi  
i PAN

Shumica e votuesve të koalicionit PAN, gjegjësisht 55.9 për qind e tyre do të votonin për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër, dhe ky subjekt do të garante vetëm. Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) do ta votonin 28.8 për qind e këtyre të rinjve, ndërsa NISMA për Kosovën do të merrte votat e 5.4 për qind të të rinjve. Një pjesë e vogël e këtyre të rinjve, kanë deklaruar se do të votonin për Lëvizjen Vetëvendosje nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin nesër. Ndërsa, 6.1 për qind e votuesve të koalicionit PAN kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.




Votuesi  
i LVV

Vetëm rreth 4 për qind e votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje do të votonin një subjekt tjetër nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin nesër. Nga kjo shifër, 1.6 për qind do të votonin për Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), ndërsa rreth 2 për qind do të votonin për ndonjë subjekt tjetër politik.


5.9 për qind e tyre kanë refuzuar të përgjigjen se për cilën parti do të votonin në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Pjesa tjetër, që përbën shumicën absolute (90.6 për qind) të votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje, do të votonin sërish të njëjtin subjekt në zgjedhje parlamentare.




Votuesi  
i LAA

Votuesit e koalicionit LAA, në masën më të madhe (84.7 për qind) do të votonin për Lidhjen Demokratike të Kosovës nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin nesër. Pjesa tjetër do të votonin për Aleancën Kosova e Re (5.8 për qind), Lëvizjen Vetëvendosje (3.7 për qind), Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (2.1 për qind) dhe Alternativën (1.6 për qind). 2.1 për qind e votuesve të koalicionit LAA kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.









Sa i përket besimit në institucione<sup>1</sup>, përkatësisht pyetjes se cili është institucioni më i besueshëm për të rinjtë, të dhënat e nxjerra nga segmentimi i votuesve tregojnë se **segmenti x** përbëhet prej të rinjve që kanë besim shumë të ulët në insti-

tucionet e ndryshme të Kosovës. Të rinjtë në segmentin më të madh, **segmenti y**, kanë kryesisht besim të pjesshëm në institucione, ndërsa **segmenti z** paraqet mendimet e të rinjve që kanë besim të lartë në këto institucione.



1 Besimi në institucione është matur duke u ofruar të rinjve mundësi të zgjedhin se sa u besojnë institucioneve përkatëse, ku 1 paraqet nivelin më të ulët të besimit (1=Aspak), ndërsa 5 paraqet nivelin maksimal të besimit (5=Plotësisht) për institucionin në fjalë.






Derisa të tri segmentet në përgjithësi ndajnë mendimin që deri diku partitë politike janë të ndikuara nga një grup i vogël njerëzish me fuqi të madhe, ata dallojnë dukshëm sa i përket dy deklaratave tjera.


Të rinjtë në **segmentin z** kryesisht besojnë që partitë politike dhe kandidatët e tyre ngrisin çështje që janë me interes për rininë kosovare (3.53) dhe se partitë në Kosovë përfaqësojnë interesat e qytetarëve (3.59), ndërsa të rinjtë e **segmentit x** besojnë të kundërtën.

Shumica e **segmentit x** dhe **segmentit y** mendojnë që puna e qeverisë është e dobët dhe joefikase. Në anën tjetër, shumica e **segmentit z** besojnë që qeveria shpesh kritikohet padrejtësisht nga njerëzit përkundër punës së mirë.



Për dallim prej **segmentit x** dhe **segmentit y**, tek të cilat vetëm përqindje të vogla të të rinjve besojnë që ndihma sociale në Kosovë është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat


elementare, 44 për qind e të rinjve të **segmentit z** janë të mendimit që ndihma sociale është e mjaftueshme.



Më shumë se gjysma e **segmentit z** (56 për qind) kanë votuar koalicionin PAN në zgjedhjet e fundit parlamentare.


Të rinjtë e **segmentit y** kanë ndarë votat tyre ndërmjet dy koalicioneve PAN (31 për qind), LAA (26 për qind) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (33 për qind), ndërsa pothuajse gjysma e **segmentit x** (48 për qind) kanë votuar Lëvizjen Vetëvendosje.





Shumica dërmuese prej 92 për qind e të rinjve të **segmentit z** dhe 87 për qind e të rinjve të **segmentit y** kanë thënë se do të votonin nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin nesër.


Ndërsa, përqindje me ulët e të rinjve të **segmentit x** (70 për qind), kanë deklaruar se do të votonin në rast të zgjedhjeve parlamentare.





Për dy segmentet e para, **segmentin x** (48 për qind) dhe **segmentin y** (24 për qind) Lëvizja Vetëvendosje do të ishte partia më e votuar në rast të zgjedhjeve parlamentare.

Në anën tjetër, 30 për qind e të rinjve të **segmentit z** do të votohnin Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në rast të zgjedhjeve parlamentare.





Segmentimi i votuesve të rinj është realizuar duke përdorur teknikën e quajtur “analiza e grumbullimit”. Kjo analizë ka nxjerrur tri segmente të ndryshme të votuesve të rinj, bazuar në përgjigjet e tyre në pyetjet që janë përfshirë në segmentim.

### **SEGMENTI I PARË, SEGMENTI**

**X(PESIMISTËT)**, përfaqëson 18 për qind të të rinjve të moshave 18 – 22 vjeç;



### **SEGMENTI Y (MESATARËT)**

është segmenti më i madh i gjeneruar nga analiza. Ky segment përbëhet prej 54 për qind të të rinjve;



### **PËRFUNDIMISHT, SEGMENTI Z**

**(OPTIMISTËT)**, është segmenti i tretë i gjeneruar dhe përfaqëson mendimet e 28 për qind të të rinjve.





# PËRFUNDIMET

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në kuadër të projektit për fuqizimin e votuesve të rinj, ka realizuar këtë seri prej dy hulumtimeve lidhur me sjelljet dhe qëndrimet e votuesve të rinj. Hulumtimi i parë është zhvilluar gjatë fundit të vitit 2016, ndërsa i dyti në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Të dhënat e marra nga intervistat e realizuara, kanë ofruar një gamë të gjerë të të dhënave mbi perceptimin e të rinjve lidhur me proceset në të cilat po kalon vendi, si dhe politikën në përgjithësi. Konkluzionet e këtij hulumtimi, lidhur me sjelljet dhe qëndrimet e votuesve të rinj, janë si në vijim:

- Problemet të cilat janë servuar nga politika në baza ditore gjatë periudhës së fundit disa vjeçare, në realitet nuk përbëjnë preokupimet e vërteta që të rinjtë kanë. Çështje si Demarkacioni, Asociacioni apo formimi i ushtrisë, janë në fund të listës së shqetësimeve që të rinjtë mendojnë se duhet adresuar.
- Asnjëra nga qeveritë të cilat kanë udhëhequr vendin gjatë periudhës së realizimit të këtyre dy hulumtimeve nuk janë marrë pothuajse fare me problemet e papunësisë, liberalizimit të vizave, shëndetësisë, apo korrupsionit, pasi që të njëjtat çështje kanë vazhduar të mbesin si shqetësimet kryesore të të rinjve, që nga viti 2016.
- Në mesin e të rinjve të Kosovës, ekziston një nivel i lartë i apatisë dhe skepticizmit ndaj partive politike dhe në përgjithësi ndaj politikës si proces. Kjo është manifestuar me nivel të lartë të mosbesimit ndaj partive politike, me krijimin e perceptimit të përgjithshëm se partitë janë vetëm mundësi për punësim apo avancim më të lehtë në karrierë, me rritjen e përqindjes së të rinjve që nuk e shohin asnjë nga figurat politike si politikan model, mungesën e komunikimit mes të rinjve dhe politikanëve, dhe të tjera. Në këtë drejtim, të rinjtë e komunitetit serb janë grupi më i distancuar nga jeta politike në përgjithësi.
- Votuesit e rinj kanë tendencë të mos jenë lojal dhe të disiplinuar ndaj subjekteve politike të tyre të preferuara, dhe gjithashtu nuk janë të prirë të ndikohen nga faktorë tjerë si familja, shoqëria, rrjetet sociale apo feja.
- Përkundër shumave të mëdha që shpenzohen gjatë fushatave parazgjedhore, këto të fundit nuk kanë qenë përcaktuese se për kë do të votojnë të rinjtë, dhe as nuk kanë pasur ndikim të madh në ndryshimin e qëndrimeve të votuesve të rinj.
- Zgjedhjet e nivelit lokal kanë trend më të lartë të pjesëmarrjes të të rinjve krahasuar me zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, votuesit djem kanë përqindje më të madhe të pjesëmarrjes në të dy palë zgjedhjet, sesa votueset vajza.





# REKOMANDIMET

## DUKE U MBËSHTETUR NË TË GJETURAT KRYESORE DHE PËRFUNDIMET E KËTIJ HULUMTIMI, INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) OFRON KËTO REKOMANDIME:

- 1

Me qëllim të rritjes së nivelit të besimit ndaj institucioneve nga të rinjtë, kërkohet përfshirje sa më e madhe e tyre në procesin e përditshëm vendimmarrës.
- 2

Partitë politike duhet t'u ofrojnë të rinjve më shumë hapësirë gjatë përpilimit të platformave politike, duke mos i kufizuar ata në aktivitete të forumeve rinore. Në këtë mënyrë, do të kishte më shumë alternativa për zgjidhjen e problemeve që të rinjtë kanë.
- 3

Qeveria duhet të adresojë me prioritet problemet e papunësisë tek të rinjtë, liberalizimit të vizave, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik dhe arsimit, probleme të cilat janë identifikuar në të dy hulumtimet.
- 4

Qeveria dhe institucionet e vendit të ndërmarrin hapa të shpejtë dhe të nevojshëm që të zhvillojnë plane afatgjate në zhvillimin ekonomik, të arsimit dhe të projekteve që përmirësojnë cilësinë e jetesës në Kosovë, dhe që të njëjtat plane të ofrojnë perspektivë të qartë për të rinjtë dhe të mos e konsiderojnë këtë kategori vetëm si një pjesë demografike që ka nevojë për projekte të vogla në kulturë dhe sport.







"KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)



Projekti është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina